



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përhershëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the Permanent Secretary

DATË/A:	07.03.2018
REFERENC-Ë:	16/4881/761/DMMU
PËR/ZA/TO:	"Shkemberi" Sh.p.k. Istog Eksplotim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në lokacionin Sine- Istog
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Z. Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë "Shkemberi" Sh.p.k. Istog, me nr. prot. 16/4881/761/DMMU të datës: 03.11.2016.

MMPH pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, bien vendimin i cili i bashkëngjitet kësaj letërpërcjellëse së bashku me Shtojcën:

1. Vendimi për Leje Mjedisore për kompaninë "Shkemberi" Sh.p.k. Istog për veprimtaritë: eksploatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në lokacionin Sine- Istog
2. Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimi Administrativ për Leje Mjedisore Nr. 07/2017.

Me respekt

Faqe 1 nga 3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning*

Zyra e Sekretarit të Përhershëm / Kancelarija Stalnog Sekretara / Office of the Permanent Secretary

Në bazë të nenit 31, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

Leje Mjedisore

Kompanisë "Shkemberi" Sh.p.k. Istog për veprimtaritë: eksploatim, thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në lokacionin Sine- Istog

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisore, vizitës në teren dhe shqyrtimit të informatave shtesë për kompaninë "Shkemberi" Sh.p.k. Istog, për veprimtaritë: eksploatim të gurit gëlqeror në ngastrën nr. 168/2, si dhe thërrmim dhe seperim të gurit gëlqeror në ngastrën kadastrale nr. 304/1, zona kadastrale Sine- Istog. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për leshuarjen e **Lejen Mjedisore**.

Operatori obligohet:

- Të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike, vlerat kufitare të cilësisë së ajrit të jenë në nivelin e lejuar;
- Raporti i rezultateve për monitorimin e cilësisë së ajrit sipas dinamikës së përcaktuar me legjislacion të i dorëzohet MMPH-s;
- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës të njoftoj MMPH;

Faqe 2 nga 3



- Sistemi i ujitjes të jetë funksional;
- Të mirëmbahet thurja e ngastrës ku behet shfrytëzimi i gurit gëlqeror;
- Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit inxhinierik që është përgjegjës për mjedis;
- Pas përfundimit të veprimtarisë, operatori është i obliguar të kthej lokacionin në gjendjen e mëparshme.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, komfor nenit 31 paragrafi 2. të Ligjit për Mbrojtje e Mjedisit Nr. 03/L-25 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 16/4881/ZSP/ 72 /18 datë: 07.03.2018.

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. *Parashtruesit të kërkesës*
2. *Komunës*
3. *DMMU-së*
4. *Inspektoratit*
5. *Kabinetit të Ministrit*
6. *Arkivit të MMPH-së*

Arben ÇITAKU

Sekretar i Përgjithshëm



Faqe 3 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mumph>, E-mail: zsp.mumph@ks-gov.net